



**SËRISH U MBLODHËM
TEK XHAMIA E PLUMBIT**



**IMANI,
BURIMI I VEPRAVE TË MIRA**



**NDJENJA FETARE
MES INSTINKTIT KOZMIK
DHE ILUZIONIT NJERËZOR**

UDHA ISLAME

Viti 23 - Nr. 11 (273), Nëntor, 2025

www.myftinia-shkoder.org

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative



MYFTINIASHKODER1990

16 NËNTOR 1990 DITA E MADHE E RIZGJIMIT TË PAKTHYESHËM!



RIHAPJA E XHAMISË SË PLUMBIT - 16 NËNTOR 1990

MYFTIU DHE ARQIPESHKVI I SHKODRËS,
BASHKË NË XHAMINË E PLUMBIT

EMOCIONET E DËSHMIVE
TË H. VEHBİ DANIT!

“DITA E RIHAPJES SË XHAMISË
SË PLUMBIT – SIMBOL I LIRISË
SË BESIMIT!”

MYFTIU I SHKODRËS
VIZITOI MYFTININË E TETOVËS

FLAMURI, BESIMI DHE FËMIJËT
– NJË DITË FESTIVE NË XHAMINË E OBLIKËS!

DR. IBRAHIM MATAR,
MIK I SHTRENJTË NË SHKODËR

MYFTIU DHE ARQIPESHKVI I SHKODRËS, BASHKË NË XHAMINË E PLUMBIT




Atmosfera e begatë e 35-vjetorit të rihapjes së kishave dhe xhamive në Shkodër dhe në mbarë Shqipërinë bashkoi sot, më 6 nëntor 2025, në xhaminë e Plumbit, Myftiu e Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari dhe Arqipeshkvin Shkodër-Pult, Mons. Giovanni Peragine, i cili vizitoi për herë të parë xhaminë e Plumbit, si simbol i rëndësishëm i lirisë së besimit dhe qëndresës së besimeve në qytetin e Shkodrës.

Pasi i uroi mirëseardhjen në xhaminë e Plumbit, Arqipeshkvi, Mons. Giovanni Peragine, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari e njohu vizitorin e nderuar me historikun e xhamisë së Plumbit dhe vlerën dhe simbolikën e madhe që ajo ka për muslimanët e Shkodrës dhe mbarë Shqipërisë.

Bashkërisht dy drejtuesit kryesorë të dy komuniteteve më të mëdha fetare në Shkodër vizituan anekset e ndryshme të këtij kompleksi të madhe të besimit dhe të vlerave të trashëgimisë shpirtërore ndër shqiptarë.

Gjatë qëndrimit në pjesën e brendshme të xhamisë së Plumbit, Myftiu dhe Arqipeshkvi dhanë mesazhet e tyre të paqes, harmonisë, bashkëjetesës dhe domosdoshmërisë së ruajtjes së vlerave të përbashkëta të besimit, duke dëshmuar si 35 vite më përpara se muslimanë dhe të krishterë janë të aftë të bashkëpunojnë dhe të ruajnë harmoninë dhe mirëkuptimin në mes vete, duke u bërë një shembull i mrekullueshëm për çdo shoqëri anembanë botës.

Dy drejtuesit e lartë fetarë iu përgjigjën mediave të pranishme edhe për ligjin e barazisë gjinore, që votohet sot në parlamentin e Shqipërisë, ku njëzëri ishin të prerë në qëndrimin e tyre kundër çdo përpjekje dhe çdo projektligji që ndryshon tabanin, traditën e shqiptarëve përgjatë shekujve dhe atë çfarë është në thelb thirrja e Zotit përgjatë shekujve, ruajtja e familjes dhe moskalimi i caqeve, që Zoti ka vendosur për mbarëvajtjen e jetës së njeriut në tokë.



SËRISH U MBLODHËM TEK XHAMIA E PLUMBIT

“**S**ËRISH U MBLODHËM TEK XHAMIA E PLUMBIT. AJO, NË MADHËSHITNË E SAJ, HIJERËNDË E PLOT DITË E RREZATIM HISTORIE, QËNDRON STOIKE, ME HESHTJEN E SHEKUJVE PLOT BESIM E PËRKUSHTIM BURRASH E NANASH BESIMTARE MBI SUPE, SI PELERINË LAVDI MBI SUPE...

SËRISH, EMRI E QJURMA E HAFIZ SABRI KOÇIT, RINISË SHKODRANE DHE BESIMTARËVE QËNDRESTARË, U KTHYEN NË FRYMËZIM QË DERRDHET MBI NE, SI LUMË BEKIMESH E MËSHIRE TË PALLOQARITUR...

NESËR, DIELLI LIND MË 16 NËNTOR..., SI NJË DËSHMI HYJNORE E TRIUMFIT TË NATYRSHËM E TË PATJETËRSUESHËM TË DITËS SË BESIMIT MBI KREJT ERRËSIRAT..!

Allahu ekber!

**IMAM MUHAMED B. SYTARI
NË ORBITËN E RIMËKËMBJES,
MË 15/11/2025**



I DASHTUNI, HAXHI FEJZI!



Sonte u mbledhëm në faltoren e Rusit tand të zemrës, në përkujtim plot mirënjohje të zotnisë tande. E di mirë, ti do doje që ky takim të ishte në xhaminë e re të Rusit, po ja që brenga ime përkarshi dëshirës tënde, më shton edhe më shumë përkushtimin për të mos e ndalur asnjëherë dinamikën e angazhimit për ta arritur atë ditë të shumëpritur, përtej çdo gjëje...

U mbledhëm, të kujtuam e në përfytyrimet tona, ti ishe sërish aty, në minberin tënd, duke elaboruar plot pathos e zemër, hytben e 35 vjetorit, duke shfaqur ndër të tjera edhe zemëratën tënde legjitime për shumë e shumë zhgënjime, nga fundi i 90-ës e deri më sot..(!?), për shumë e shumë.., që gjithsesi, nuk dua ta prish përshtypjen e këtij kushtimi, me përmendjen e tyre..!?

Ti u largove me faqe të bardhë. Me karizmen tënde, me zërin kumbues e

gatishmërinë e pashembullt, për të qenë përherë aty, ku shumëkush, do të dëshironte të ishte pluhur heshtjeje, sesa të thirrej e të mbulohej me perden e heshtjes së brendshme... Ishte rizku jot, ishe shembull vetmohimi, ishe vetmitar në llojin tënd e, përtej rrobës tënde... Ishe, mbete e do të kujtohesh, si i përkushtuar pa asgjë në këmbim.., përveç një gjëje në mes zemrës tënde e Zotit të saj!

U largove.., dhe si shehid të përcollëm, teksa sot, në këtë mbrëmje përkujtimore, zëri yt sërish kumboi, edhe muret e faltores tënde kishin mall..

Na fute në mendime e, duke na ngarkuar edhe me më shumë respekt e vlerësim për gjurmën tënde unike, e përfundove fjalinë e ligjërimit tënd të fundit, me lutje për Shkodrën..!

Allahu të mëshiroftë, Haxhi!

Imam Muhamed B. Sytari

Në lutje, më 11/11/2025



H. VEHBI S. GAVOÇI
(1923 - 2013)

“**S**A MIRË ËSHTË TË BASHKËPUNOJNË BESIMTARËT, MËSUES E STUDENTË, PËR TË LUFTUAR DISA BIDATE TË MËDHA QË PO PËRHAPEN NË VENDE TË NDRYSHME TË BOTËS ISLAME, SI P.S.H: MOS INTERESIMI PËR TË NDIHMUAR DHE PËR TË LARQAR VUAJTJET E TË KËOIJAT NGA VËLLEZËRIT MUSLIMANË KUDO QË TË JENË.

ME U PËRPJEKË ME PLOTËSU KËRKESAT E FESË DUKE BASHKËPUNUAR ME VËLLEZËR DHE NË QOFTË SE QJENDEN DISA NDRYSHIME TË VOGLA NDËRMJET TYRE, SI NË KATËR MEDH-HEBET QË NDRYSHOJNË NGA NJËRI-TJETRI NË DISA PIKA, PASI VETË SAHABËT E PROFETIT (A.S.) KANË PASUR NDËRMJET TYRE DISA NDRYSHIME.

(Nga libri: Syneti e bidati)



16 NËNTOR 1990 – DITA E MADHE E RIZGJIMIT TË PAKTHYESHËM!

Muaji nëntor i vitit 1990, është i ngarkuar me ngjarje të shënuara, detajet e së cilave do të regjistrohen me shkronja të arta në Murin e Nderit të kombit shqiptar!

Nga Kisha e Rrmajit dhe Xhamia e Plumbit, dorë për dorë, muslimanë e të krishterë, ishin aty për të dëshmuar Dritën e shpirtit të lirë e besimtarë, që po vërshonin më bindshëm se kurrë drejt dyerve të besimit e të fesë, duke respektuar, ndihmuar e mbështetur pa asnjë paragjykim e rezervë njëri-tjetrit!

“Lavdi t’Madhit Zot!”, ishte thirrja madhështore e dhjetëra mijëra besimtarëve e qytetarëve shkodranë, në përcjellje të Mesazhit të paharruar të Kryemyftiut të sprovuar në burgjet e komunizmit, Hirësisë së Tij, H. H. Sabri Koçi!

Dhe, vitet kaluan, të mbushura me përpjekje e sakrifica të mëdha në rrugën e ripërtëritjes dhe ringritjes së Ndërtësës së pathyeshme të trashëgimisë shekullore të besimit, fetarizmit të shëndoshë, harmonisë e paqes sociale në këtë vend.

Me qindra prijës fetarë, imamllarë, hatibë, muezinë, vaizë e myderrizë, u angazhuan me durim e sakrificë, në kushte të vështira e pengesa të panumërta, në këtë rrugëtim të paqte të kësaj Qëndrese plot vetëmohim, në rrugën e rizgjimit të pakthyeshëm e të

pathyeshëm të vetëdijes kombëtare!

Ata, vazhdojnë në këtë rrugëtim, larg zhurmës e prozhektorëve, në zemër të qytetit e në çdo fshat të afërt e të largët, duke bërë më të mirën e mundshme, plot dashuri e sakrificë!

Dhe, ja ku jemi sot, kur edhe pak ditë na ndajnë nga ajo ngjarje e gdhendur në memorie, që shndrit si diell vezullues, duke na ndriçuar rrugën drejt asaj që vjen, për të qëndruar të pathyeshëm kundër taborrave të Iblisit dhe cytjeve të tij gjenetike!

Teksa Hz. Ibrahim i madh, po shkonte drejt finalizimit të aktit sublim të përgjigjes së vendosur e besimtare, shoqëruar nga i biri besimtar e thellësisht i bindur në urtësinë e Krijuesit dhe madhështinë e urdhrit të Tij, rrugën ia preu shejtani i mallkuar, që me lajka e shpirtin tinzar, po përpiquej ta thyente të përkushtuarin Ibrahim... Dhe, Miku i Allahut, e gjuajti me gurë shejtanin cytës, ashtu siç gjuajmë me gurët e indinjatës, dhe dënimit të patolerueshëm, këdo, të dukshëm e të padukshëm, me pushtet verbues e nën çatinë e pushtetit pa ekuilibër, që përpiket me cinizëm e meskinitet të na e prishë këtë atmosferë të shumëpritur me shpirt qelibar të këtij jubileu të 35-të të përkujtimit të dyndjes së madhe popullore kundër diktaturës, putnave të saj e krejt të verbuarve mediokër me pushtetin e dhunës, terrorit e shtypjes!

Në këtë atmosferë të shtrenjtë e të paprekshme, Myftinia Shkodër dënon çdo akt dhune, shkeljeje flagrante dhe denigrimi të pronës private dhe simbolikave tona të shenjta, me të cilat u përballua (paradoksalisht!?) mbrëmjen e së dielës, më 9/11/2025, në 9 nëntorin e shembjes së Murit të Berlinit, xhamia e vakëfi jonë i shenjtë në Fushë Çelë!

Myftinia Shkodër garanton besimtarët se dosjen e plotë të kësaj ngjarjeje të paprecedent do ta dërgojë pranë organeve kompetente, në mënyrë që personazhet e errësirës dhe hijet e mbetura të së shkuarës dhe dhunimit të vendeve të shenjta, të ngelen në sirtarët e historisë! Sikurse refuzon kategorikisht gjuhën e papërkthyeshme dhe të papranueshme të cilitdo, që i ka hipur dallgës përsëmbrapshti!

Myftinia Shkodër falënderon të gjithë drejtuesit e komuniteteve fetare, deputetët, mediat dhe shoqërinë civile për sensibilizimin dhe mesazhet e urta të mbështetjes dhe solidarizimit, të ardhura në adresën tonë!

Lutemi që në këtë 35 vjetor të përkujtimit të madh të Burrave të urtë e prijësve vizionarë të fesë e të kombit, secili të reflektojë në vetvete, për t’u përmirësuar në marrëdhënie me Zotin, natyrën e tjetrin, kushdo qoftë ai, sepse më i dashuri i krijesave të Allahut, për Zotin e gjithësisë, është “më i dobishmi i tyre për ta!”, siç na mëson feja e jonë!



Naim Drija

Imam - Xhamia Parrucë

Imani (besimi) është tema që më së shumti Allahu (xh.sh) flet për të në Kur’anin Famëlartë.

1. Imani i legjitimon veprat. Imani është motivuesi i veprave të mira, por gjithashtu është edhe ai që i jep legjitimitet veprave të mirë. Sa herë që Allahu na thërret për të bërë punë të mira, Ai e bën këtë përmes imanit. Allahu (xh.sh) thotë: “O ju që keni besuar...”, kjo është bërë obligim për ju: largohuni nga kjo, kryejini këtë, ndihmohuni në këto dhe kështu me radhë. Po ashtu ka raste të shumta ku Allahu (xh.sh) thotë: “Largohuni...” nga kjo, bëni këtë, zbatoheni këtë rregull, ndiqni këtë mësim, e kështu me radhë, nëse jeni besimtarë.

Allahu (xh.sh) në shumë vende në Kur’an thotë: “Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira.”¹ Allahu (xh.sh) thotë: “Për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, ka falje dhe shpërblym bujar”.²

Çdo vepër që imani nuk e legjitimon si të mirë, largohu prej saj, sepse nuk ka hajr në të. Imani nënkupton singjeritetin dhe pasimin e Pejgamberit (a.s). Këto dy janë kriteret themelore për legjitimitimin e çdo vepre që e ngre atë në nivelin e veprës së mirë dhe të pranuar. Nëse ka

1. Er- Rad, 29.
2. El-Haxh, 50.

IMANI, BURIMI I VEPRAVE TË MIRA

iman, shtohen veprat e mira, dhe nëse dobësohet imani, shtohen veprat e liga.

2. Imani na mëson që ta bëjmë punën në mënyrën më të mirë. Imani na mëson cilësinë dhe përsosmërinë. Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Allahu dëshiron (kërkon) nga robi i Tij, që kur të bëjë një punë, ta përsosë atë!”³

Profeti (a.s) gjithmonë i nxiste sahabët për cilësi. Kur sahabët rreshtoheshin për namaz, u thoshte: “Falenë namazin sikur të ishte namazi i fundit i juaj.”⁴ Gjithashtu, Pejgamberi (a.s) thoshte: “Allahu është i mirë dhe nuk pranon tjetër, përveç asaj që është e mirë.”⁵ Nëse do që Allahu ta pranojë një vepër, bëjeni siç duhet dhe sipas udhëzimeve që na ka mësuar Pejgamberi (a.s).

Besimi është sikur numri një para shumë zerove; edhe pse veprat e mira mund të jenë të shumta, pa besim, ato humbasin vlerën e vërtetë. Sikur zerot marrin vlerë për shkak të njëshit, po ashtu edhe veprat marrin vlerë për shkak të besimit.

3. Imani na mëson edhe për vazhdimësinë e veprave. Çdo vepër që kryhet përmes imanit është e vazhdueshme, sepse për sa kohë në zemër ka iman, ka edhe vepra. Vazhdimësia në bamirësi kushtëzohet me vazhdimësinë e funksionimit të imanit në zemrat tona.

Kur Pejgamberi (a.s) ndërroi jetë, sahabët u mërztën shumë. Aq sa Umeri (r.a) tha: “Kush thotë se Muhammedi (a.s) ka vdekur, ka punë me mua!” Ndërsa Ebu Bekri (r.a) u ngrit dhe tha: “O muslimanë! Kush ka adhuruar

3. Sahih el-Xhami, 1880.
4. Ahmedi, 23545. Ibn Maxheh, 4171. Silsiletu Sahiha, 401.
5. Muslimi, 1015.

Muhammedin, ta dijë se ai ka ndërruar jetë. Kush adhuron Allahun, ta dijë se Ai është i Gjallë dhe nuk vdes kurrë”. Pastaj lexoi ajetin Kur’anor: “Muhammedi nuk është tjetër, veçse një i dërguar. Edhe para tij pati të dërguar. E nëse ai vdes ose vritet, a do ta lini fenë e tij? Ai që le fenë e Allahut le ta dijë se nuk i bën dëm Zotit...”⁶ Sahabët thanë: “Na u duk se ky ajet kishte zbritur për herë të parë”.⁷

4. Imani na mëson të ruajmë pastërtinë e besimit dhe të mos e njollosim atë. Por, nëse bëjmë ndonjë punë të keqe, na mëson të pendohemi. Ai që ka iman në zemër, pendohet. Kur imani aktivizohet, i mundëson njeriut të shohë shëmtinë e veprës së keqe që ka bërë. Prandaj nëse imani është funksional, ka edhe pendim!

Besimtari, përmes pendimit dhe imanit, mund të shndërrojë punën e keqe në punë të mirë. A ka inkurajim më të madh se kjo ofertë e Allahut për pendim? Allahu, për shkak të pendimit dhe rifunksionimit të imanit, i shndërron veprat e këqija në vepra të mira: “Përveç atij që është penduar dhe ka bërë vepër të mirë, të tillëve Allahu të këqijat ua shndërron në të mira. Allahu është Mëshirues, ndaj Ai falë shumë”.⁸

Imani, në çdo rast, është burim përfitimi për ne; kur bëjmë punë të mira, ai i shumëfishon ato, dhe kur bëjmë punë të këqija, përmes pendimit i shndërron në punë të mira. Ky është funksionimi i imanit.

Zoti e shtoftë besimin në zemrat tona, në familjet tona dhe në shoqërinë ku jetojmë. Allahu na mundësoftë që ta jetojmë jetën si muslimanë dhe shpirtin ta japim si besimtarë.

6. Ali Imran, 144.
7. Buhariu, 3668.
8. El-Furkan, 70.

IMANI NA MËSON CILËSINË DHE PËRSOSMËRINË. PEJGAMBERI (A.S.) KA THËNË: “ALLAHU DËSHIRON (KËRKON) NGA ROBI I TIJ, QË KUR TË BËJË NJË PUNË, TA PËRSOSË ATË!”



Arben Halluni, teolog

Lind pyetja: Nëse forca e krijimit është një forcë kozmike që manifestohet tek disa të frymëzuar, atëherë pse duhet të jetë ajo... ndjenja fetare shoqërore, çfarë është ajo tjetër veçse një trillim apo një mashtrim që nuk ka asnjë bazë përveç imagjinatës së thjeshtë të mbijetuar?

Pse ajo të mos jetë vetëm një iluzion i krijuar nga mallëngjimi, nga ndjeshmëria e jashtëzakonshme?

Pse ajo të mos jetë vetëm një fillim i besimit të gabuar, i cili u përhap përmes zakoneve të trashëguara dhe pastaj u harrua origjina e tij, derisa njerëzit nisën të kërkojnë prej tij një jetë tjetër pas kësaj jete, një botë të padukshme dhe të fshehtë?

Dhe për të dëgjuar një tjetër mendim të besueshëm në këtë fushë, shikojmë hulumtimet e dijetarëve modernë të gjuhës, si (Max Müller), i cili është përfaqësuesi i mendimit të gjerë mbi etimologjinë e fjalëve, domethëniet e tyre dhe lidhjen e tyre me mitet dhe legendat. Sipas tij, vetë instinkti i njeriut për njohjen e realitetit dhe për perceptimin e botës është një shtysë e natyrshme që e shoqëroi atë që nga periudhat më të hershme.

Ky duhet të marrë mbështetje kur thotë se shfaqja e miteve dhe legendave përshkon çdo hap të njeriut drejt së panjohurës, sepse njeriu e

NDJENJA FETARE MES INSTINKTIT KOZMIK DHE ILUZIONIT NJERËZOR

ndjeu madhështinë e gjithësisë dhe pafundësinë e saj, që nuk ka mbarim, dhe kjo madhështi e përhap tek ai frikën dhe tmerrin. Prandaj, ajo që e shihte në hënë, në diell apo në yje, nuk ishte tjetër veçse një shkëlqim ndriçues, kështu që mitet dhe besimet nuk janë veçse një qendër që lëviz rreth krahasimeve mes gjuhëve dhe dialekteve.

Nëse e marrim parasysh mendimin e Müllerit për “mungesën e fillimit” ose “pamundësinë e fillimit”, atëherë kuptojmë se nuk ka një fjalë në gjuhët primitive dhe në gjuhët e qytetërimit të hershëm që të thotë se ndjesia i paraprin shpikjes së fjalëve. Është vërtetuar se njeriu i parë nuk e shfaqti këtë në fjalorin e tij përveç disa fjalëve që lidhen me ngjyrat.

Dhe tani, për atë që na bën të mendojmë, ne kemi besuar se supozimet që na kalojnë në mendje për analizimin e besimit fetar, ose për të shpjeguar origjinën e tij të parë, janë thjesht supozime. Dhe secili nga ato supozime nuk mund të jetë i pavarur për të mbuluar të gjitha shkaqet e besimit. Përkundrazi, na duhet të shohim përtej tyre. Çfarë kuptojmë ne nga kjo është se çështja e besimit është më e madhe se sa ta përmbledhim me një shpjegim të vetëm. Ajo është e aftë të përfshijë të gjitha këto interpretime së bashku, dhe mbetet gjithmonë e hapur për kërkime dhe studime të reja.

Duhet të pranojmë se kjo lidhje e ngushtë mes vetëdijes dhe ndjenjës, është gjithmonë e pranishme në ekzistencë, përderisa ekzistojnë ata që kanë vetëdije dhe ndjenja.

Dhe nga gjërat e çuditshme është se dijetarët nuk e quajtën këtë një instinkt të vetëdijes, por diçka që e quajtën instinkt kozmik ose një lidhje kozmike me gjërat. Dhe në të vërtetë, kjo lidhje me gjithësinë dhe me ekzistencat e saj është e dukshme në të gjitha krijesat.

E vërteta është se vetëdija nuk mund të përfshijë çdo gjë, as mendja nuk mund ta përmbledhë atë plotësisht, sepse ekziston diçka më e lartë se ajo, një mbretëri e gjerë që përfshin gjërat që vetëdija nuk mund t'i kapë. Dhe pikërisht kjo lidhje është ajo që i dha njeriut aftësinë për të ecur përpara dhe për t'u ngritur lart, sepse të vërtetat që nuk arrijnë dot tek kuptimi dhe perceptimi i njeriut, mbeten gjithmonë mbi të dhe e udhëheqin atë në rrugën e progresit.

Prandaj, shfaqen shqisat materiale që nuk përfshihen vetëm te shikimi dhe dëgjimi, por edhe te nuhatja dhe ndjenja e shijes. Disa kafshë, për shembull, kanë aftësi për të nuhatur gjëra të largëta që njeriu nuk i dallon, apo të zbulojnë gjëra përmes erës. Disa zëra kapen nga aparate të posaçme që nuk i arrin veshi njerëzor. Para epokës së sotme nuk dihej se tingulli përhapet në ajër përmes valëve dhe frekuencave. Po ashtu, shikimi nuk e kapte dot diçka përtej asaj që shihte syri, derisa u zbuluan pajisjet që e zgjeruan fushën e tij.

Nga këtu kuptojmë se “gjithësia e vetëdijes kozmike” është më e gjerë se sa fusha e shqisave dhe perceptimeve njerëzore. Përderisa lidhja mes njeriut dhe gjithësisë është një lidhje e vazhdueshme dhe e thellë, atëherë ajo duhet domosdoshmërisht të hyjë në fushën e vetëdijes dhe të perceptimeve të tij, qofshin ato të arsyeshme apo të paarsyeshme. Për këtë arsye u formuan synime të caktuara në mendjet e njerëzve, që gjetën zbatim te forcat e fshehta të natyrës, dhe nga aty u ngritën aftësitë e besimit dhe të bindjes.

Në këtë univers të madh gjenden të vërteta që nuk i përputhen plotësisht shqisave trupore, as perceptimeve psikologjike, deri më sot.



Evans Drishti

Mësues - Medreseja "H. Sheh Shamia"

Teksa përditshmëria e medias vizive dhe të shkruar gëlon në trajtesat e fenomeneve nga më të thjeshtat, siç mund të jetë prezantimi i një personazhi të njohur, deri tek ato më absurdet, sikurse po gjen shtrirje të frikshme “fenomeni i gjinisë”, e kemi të nevojshme të sjellim vëmendjen tonë tek filizat e rinj të talentuar, që fatkeqësisht po rriten në “minorancë” dhe në “heshtje”

Po e cilësojmë si “fenomen”, pasi vërtet i tillë është djali në fjalë.

Ai është një fëmijë që hedh shtat dita ditës me hov të dukshëm, ashtu sikurse është edhe për nga natyra. Ka një fytyrë si të kuruar me ëmbëlsi të veçantë, thua se ëngjëllorë, të cilën e karakterizon një buzëqeshje shumë e fisshme me një pamje hijerëndë.

Një trup i rregullt që paralelizohet edhe me tiparet e tij të një djaloshi shumë të rregullt, që karakterizohet nga një korrektësi dhe shkathtësi e dukshme kudo e në çdo rast.

Intuita e tij e mprehtë ia lehtëson punën për t'i përvetësuar dhe poseduar njohuritë që merr gjatë proceseve edukative dhe shkencore duke të lënë

NJË FENOMEN I DITËS DHE I KOHËS

të kuptosh se i duhet diçka më shumë nga ajo që ofrohet. Cilado lëndë qoftë, për të është mëse e arrirë, e qartë, e kuptueshme, e mbi të gjitha argëtuese, pasi kanë mjaftuar vetëm pak minuta që ai ta nxë në çast, dhe gjithçka më pas është e tija. Kabineti i një procesi mësimor për të është sa komod dhe i rehatshëm, po aq edhe i pamjaftueshëm, pasi urtësia që e karakterizon gjithnjë e bën atë të ndjekë çdo lloj procesi me këmbë në tokë, e nga ana tjetër, është mëse i vetëdijshëm se duhet të kapërcejë shumë më tutje.

I arrirë në shumë organizime sociale e kulturore; elekuent në shpjegime dhe interpretime, i saktë dhe koherent në analiza të çështjeve të ndryshme shkencore apo shoqërore, ai e bën menjëherë dallimin nga të tjerët, pasi gjithçka është në natyrshmërinë e tij. Bashkëpunues me shokët dhe miqtë e tij, dashamirës dhe largpamës në shtrimin e ideve të ndryshme, e gjen përherë në qendër të vëmendjes i mbështjellë nga një qëndrim djaloshar i pjekur dhe kthjelltësi në atë çfarë reflekton.

I tillë është Unejs Heta, një nxënës që aktualisht mëson në Medresenë “Haxhi Sheh Shamia” dega e djemve, në Shkodër, në klasën e 8-të, por që në fakt nuk është qëllimi i këtij prezantimi tek shkolla, por tek vetë personi, për vetë rëndësinë që duhet të mbartë ky filiz në rritje, pasi jemi mëse të bindur se të tillë dhe të ngjashëm natyrshëm ka në çdo shkollë, ashtu sikurse ruajmë bindjen se për fat të keq kjo kategori e të tillë fëmijëve mbetet në minorancë duke mos gjetur hapësirë të duhur dhe të bollshme prezantimi.



Pikërisht në këtë ditë të shënuar në kalendarin e festave të nëntorit 2025, spikat, sikurse të tjerët, edhe Unejsi, me paraqitjen e tij dinjitoze në interpretimin e realizuar me rastin e festave të nëntorit, duke treguar një korrektësi gjatë tërë provave duke shfaqur natyrshëm një dëshirë dhe pasion të hekurt për të na dhënë të kuptojmë se nuk është thjesht dhe vetëm njohuria lëndore ajo që nevojitet, përkundrazi është ofrimi i hapësirave sociale e kulturore që e bëjnë akoma më të plotësuar si individ, dhe nesër si intelektual.

Ndaj që në fillim e cilësuam “Fenomeni i ditës dhe i kohës”, pasi kjo është dita dhe koha e tij, kjo është epoka e tij,

Ka shumë rëndësi që fëmija të marrë mbështetje dhe dashuri në të gjitha hapat e tij të rritjes, sepse vetëm në këtë mënyrë arrin të formësohet dhe të plotësohet si në aspektin intuitiv ashtu edhe në atë kulturor. Ndaj mirënjohje dhe respekt për familjen e tij që kanë edukuar një filiz të tillë model duke i dhënë frymëmarrje dhe shpresë shkollës ku mëson dhe mbarë shoqërisë për të gjetur frymën optimiste drejt zhvillimit dhe integritetit.

PROMOVHET LIBRI: “LËVIZJA PËR RIVENDOSJEN E LIRISË SË BESIMIT FETAR NË SHKODËR 1989-1990”, I AUTORIT PROF. DR. BAJRAM XHAFA

Myftinia Shkodër, në kuadër të aktiviteteve të larmishme të 35 vjetorit të lirisë së besimit, zhvilloi pasditen e së enjtes, më 13 nëntor 2025, promovimin e librit: Lëvizja për rivendosjen e lirisë së besimit fetar në Shkodër 1989-1990, të autorit të mirënjohur, Prof. Dr. Bajram Xhafa.

Të ftuar në këtë promovim ishin intelektualë, shkrimtarë, përkthyes, imamë, besimtarë dhe drejtues të ndryshëm të bibliotekës së qytetit.

Në krye të herës, teologu Arben Halluni bëri një paraqitje të librit dhe vlerave të tij, duke u përqendruar tek periudha 1989 – 1990, ku nisi të formësohej dhe të merrte rrugë përpjekja dhe lëvizja popullore për hapjen e objekteve të kultit në qytetin e Shkodrës.

Gjatë fjalës së tij, teologu Halluni vlerësoi kontributin e autorit dhe solli në vëmendje disa prej detajeve me vlerë të këtij libri që gjithsesi është një pasuri e shtuar për bibliotekat e qytetarëve shkodranë.



shprehu një falënderim të drejtpërdrejtë për autorin e librit, Prof. Dr. Bajram Xhafa, ku ndër të tjera iu drejtua duke i thënë: “Ju i nderuar, Prof. Bajram Xhafa me veprën tuaj dhe aktivitetin tuaj në vazhdueshëm jeni një pikë frymëzimi për të gjithë ne për të respektuar librin dhe për të mos u ndarë nga bota e shkrimit, sepse sikurse lexojmë edhe në Kur’anin Famëllartë, Zoti i gjithësisë është betuar për lapsin, për hokën e bojës dhe për çfarë shkruhet, dhe për këtë ju meritoni një falënderim të madh” – përfundoi Myftiu.

Myftiu i Shkodrës e përfundoi fjalën e tij, duke ftuar për një fjalë rasti dhe për një përshëndetje me shumë vlerë mikun e shtrenjtë të Myftinisë Shkodër Dr. Ibrahim Matar, i cili ka mbërritur në qytetin e Shkodrës

nga Damasku i Sirisë për një vizitë disa ditore për të ndarë me stafin e Myftinisë Shkodër dhe imamët e saj, por jo vetëm, eksperiencat e tijtë pasura në aktivitetin e larmishëm në fusha të ndryshme të Thirrjes Islame, udhëtimeve dhe shërbimeve të panumërta gjatë pesë dekadave të fundit të jetës së tij.

Me shumë emocion të pranishmit ndoqën edhe fjalën e mbajtur nga Dr. Ibrahim Matar, mik i Myftinisë Shkodër në këtë atmosferë të begatë të këtij viti jubilar.

Në fjalën e tij, Dr. Matar shprehu kënaqësinë e tij të madhe për këtë vizitë të parë në Shqipëri dhe Shkodër

veçanërisht, duke theksuar se ndjehet shumë i lumtur dhe i befasuar nga bukuria e shpirtit të njerëzve, natyrës dhe çdo detaji në qytetin e Shkodrës.

Gjatë fjalës së tij, ai bëri një paralele ndërmjet gjendjes së mjerueshme me të cilën u përballën shqiptarë gjatë periudhës së komunizmit me atë, me të cilën u përball populli sirian gjatë periudhës së errët të regjimit të kaluar.

Ai theksoi se revolucion i ndryshoi rrjedhat e historisë në Siri është një mirësi e madhe dhe një bekim nga Zoti, siç edhe nëntori i vitit 1990 ishte një revolucion i ngjashëm për ndryshimin e realiteteve shqiptare.

Ai falënderoi Myftiun e Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari për ftesën bujare dhe u lut që Shqipëria dhe shqiptarët të kenë përherë prosperitet, mirëqenie, begati, harmoni dhe bekime pafund nga Zoti i gjithësisë.

Me shumë kënaqësi të pranishmit dëgjuan fjalën e autorit të librit, Prof. Dr. Bajram Xhafa, i cili tregoi për prapaskenat e përgatitjes së këtij libri, ku theksoi ndër të tjera: “Përgatitja e këtij libri më ka kushtuar 15 vite jetë. Edhe sot e kësaj dite, kur libri ka dalë në qarkullim, mendoj se po të mos ishte botuar, do të kisha shtuar akoma edhe më.”

Autori falënderoi Shtëpinë Botues Alsar dhe të gjithë bashkëpunëtorët e tij, duke vënë theksin te rëndësia që ka regjistrimi i ngjarjeve të ndryshme historike për të dëshmuar me argumente të qarta atë çfarë është jetuar dhe dëshmuar në këtë vend, me shpresën që e keqja të mos përsëritet më, dhe rezistenca ndaj të keqes të promovohet si vlerë e shtuar në mesin e njerëzve.

EMOCIONET E DËSHMIVE TË H. VEHBI DANIT!

Ditën e xhuma, më 7 nëntor 2025, pas namazit të iqindisë, Myftinia Shkodër organizoi në xhaminë e Plumbit një aktivitet mbresëlënës në qendër të së cilit ishte i ftuari special i këtij aktiviteti, H. Vehbi Dani, një nga personazhet emblematic të ngjarjeve të shënuar të 16 nëntorit 1990.

Kushdo që e ka parë me vëmendje filmën e 16 nëntorit 1990, që Myftinia Shkodër zbuloi dhe e shfaqti për herë të parë për të gjithë të interesuarit, ka vënë re një nga personazhet më të spikatur të asaj dite, pikërisht muezinin e ditës së xhuma, zëri i të cilit kumbon fort teksa thërret pas 23 vite ndërprerje të ezanit fjalët e mrekullueshme: “Allahu Ekber, Allahu Ekber”.

Ishte pikërisht H. Vehbi Dani, ish nxënës i Medresesë së Tiranës, nxënës i përkushtuar i një plejade hoxhallarësh të shquar të Shkodrës si: Hfz. Sabri Koçi (asokohe imam i xhamisë së Rusit), H. Sulejman Kraja (asokohe imam i xhamisë së Dudasit), H. Qamil Tresi (asokohe imam i xhamisë së Ndocejve), prej të cilëve mësoi leximin e Kur’anit, shkrimin e arabishtes, e shumë e shumë njohuri dhe mësim me dobi rreth fesë së madhërueshme islame.

Në bashkëbisedimin e sotëm, që teologu Arben Halluni zhvilloi me mësuesin e tij të parë të gjuhës arabe dhe Kur’anit, H. Vehbi Dani, dolën në pah veçori, njohuri dhe detaje të spikatura të periudhës parandalimit të fesë në vendin tonë, pas viteve 1967 dhe emocionet e dinamika e gjerë e prag hapjes së xhamisë së Plumbit, më 16 nëntor 1990.



Nëpërmjet emocioneve që e shoqëronin këtë bashkëbisedim, i nderuar H. Vehbi Dani hodhi dritë mbi shumë detaje dhe kujtime të paharruara, që shënohen me shkronja të arta e që falin emocione të mëdha. Të gjitha së bashku mblidhen në një pikë të vetme, që kjo fe e madhërueshme islame nuk shuhet kurrë, ashtu si dielli i cili shndritë mbi gjithësi.

Në përfundim të fjalës së tij, H. Vehbi Dani dha disa këshilla me vlerë për imamët, Myftiun dhe në veçanti për rininë ku theksoi se lypset që drita e besimit të mbërrijë tek rinia, sepse një rini e udhëzuar me dritën e besimit dhe të fesë është garanci për të sotme dhe të ardhmen e atdheut, kombit dhe mbarë njerëzimit.

Aktiviteti u përshëndet edhe nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili theksoi se aktiviteti i sotëm ishte i mbushur me emocione dhe se u ndje i rrethuar nga bekimet dhe mëshira e Allahut të Madhëruar, sidomos gjatë përmendjes së emrave të nderuar të

hoxhallarëve të shquar të Shkodrës, për çka falënderoi të nderuarin H. Vehbi Dani dhe i uroi atij jetë të gjatë dhe shëndet të plotë në shërbim të mësimave dhe udhëzimit islam.

Aktivitetet me rastin e 35 vjetorit të rihapjes së xhamisë së Plumbit dhe rilejimit të fesë me ligj në vendin tonë do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim, sipas programeve që Myftinia Shkodër ka përgatitur dhe për të cilat do të lajmëroheni në ditët në vijim.



MALAVI OSE REPUBLIKA E MALAVIT

Malavi, zyrtarisht ‘Republika e Malavit’, është një vend në Afrikën juglindore, pa dalje në det, dhe kufizohet nga Tanzania në veri dhe verilindje, nga Mozambiku në lindje, jug dhe jugperëndim, dhe nga Zambia në perëndim. Malavi ka një sipërfaqe prej mbi 118,484 km², dhe një popullsi prej 22,224,282 banorësh (korrik 2025).

Lilongve është kryeqyteti dhe qyteti më i madh i vendit, ndërsa tre qytetet e tjera më të mëdha janë Blantire, Mzuzu dhe Zomba (ish-kryeqyteti).

GJEOGRAFIA

Peizazhi i Malavit është shumë i larmishëm, nga ku mund të identifikohen katër rajone kryesore: Lugina e Riftit të Afrikës lindore, pllajtat qendrore, malësitë, dhe malet e izoluar.

Lugina e Riftit të Afrikës lindore - tipari mbizotërues i vendit - është një ultësirë e gjerë në formë grope, që kalon nëpër vend nga veriu në jug, dhe përmban liqenin Malavi (në veri dhe në qendër) dhe luginën e lumit Shire (në jug). Bregu i liqenit përgjatë brigjeve perëndimore dhe jugore të tij, varion nga 8 deri në 24 km në gjerësi, dhe mbulon pothuajse një të dhjetën e sipërfaqes totale të tokës së vendit. Kjo pjesë përmban kënetat dhe laguna.

‘Lugina Shire’ shtrihet rreth 400 km nga skaji jugor i liqenit Malavi e deri në Nsanxhe, në kufirin me Mozambikun, dhe përmban liqenin Malombe në skajin e tij verior.

Pllajtat e Malavit qendror ngrihen në lartësinë 760 -1370 metra dhe shtrihen në perëndim të liqenit Malavi. Rrafshnaltat mbulojnë rreth tri të katërtat e sipërfaqes totale të territorit të vendit.

Zona e malësive është kryesisht e izoluar, dhe ngrihet deri në 2,400 metra mbi nivelin e detit. Ajo përfshin malësitë Njika, Vipha dhe Dova dhe vargmalin Dedza-Kirk në veri dhe perëndim, dhe malësitë Shire në jug.

Masivet e izoluar malore Mulanxhe (që arrijnë deri në 3,002 metra, dhe përbëjnë pikën më të lartë në vend) dhe Zomba (2,087 m), përfaqësojnë rajonin e katërt fizik të Malavit, dhe kapërcejnë malësitë Shire, pastaj zbresin me shpejtësi në lindje, në fushën e liqenit Çilva-Phalombe.

Liqeni Malavi (29,600 km²) është liqeni më i madh në vend dhe shtrihet përtej kufirit të republikës. Ai ushqehet nga lumenjtë: Rukuru Verior dhe Rukuru Jugor, Dvangva, Lilongve dhe Bua. Lumi Shire, dalja e vetme e liqenit Malavi, rrjedh përmes liqenit Malombe ngjitur dhe merr me vete disa degë para se të bashkohet me lumin Zambezi në Mozambik. Liqeni i dytë për nga rëndësia është liqeni Çilva dhe lumenjtë që e ushqejnë atë rrjedhin nga fusha përreth liqenit Çilva -Phalombe dhe malësitë ngjitur.

Malavi ka dy vende të listuara në Listën e Trashëgimisë Botërore të



UNESCO-s: Parku Kombëtar i liqenit Malavi (i listuar për herë të parë në vitin 1984) dhe Zona e Artit Shkëmbor Çongoni (e listuar në vitin 2006).

KLIMA

Malavi ka klimë subtropikale. Sezoni i lagësht është zakonisht nga nëntori deri në prill. Sasia mesatare e reshjeve gjatë kësaj periudhe është 725 - 2,500 mm. Nga maji në gusht është sezoni i freskët dhe i thatë. Gjatë kësaj kohe temperaturat variojnë mes 17 dhe 27 gradë Celsius. Sezoni i nxehtë dhe i thatë ndodh mes shtatorit dhe tetorit, kur temperaturat variojnë midis 25 dhe 37 gradë Celsius.

EKONOMIA

Shtylla kurrizore e ekonomisë së Malavit është bujqësia, e cila në vitet

2000 punësonte më shumë se katër të pestat e popullsisë punëtore dhe përbënte rreth një të tretën e produktit të brendshëm bruto (PBB), si dhe pjesën më të madhe të të ardhurave nga eksporti. Duhani, kultura më e rëndësishme e eksportit, përfaqëson një pjesë të madhe të të ardhurave tregtare të vendit; çaji, sheqeri dhe pambuku janë gjithashtu produkte të rëndësishme. Misri, fasulet, bizelet dhe kikirikët, janë kultura kryesore ushqimore në vend. Kultura të tjera të rëndësishme ushqimore përfshijnë maniokun, bananet, bishtajoret, patatet e ëmbla dhe orizin. Atje rriten gjithashtu

pula, bagëti, dele, dhi, etj. Atje gjenden plantacione të mëdha të drurit; pisha dhe eukalpti janë mbjellë gjithashtu gjerësisht në malet veriore Vipha.

Peshkimi praktikohet për jetesë, por edhe në mënyrë artizanale dhe komerciale, dhe liqenit dhe lumenjtë e Malavit ofrojnë një sasi të larmishme të peshkut. Liqeni Malavi në veçanti është një burim i pasur peshku me qasje të lehtë për pjesën më të madhe të popullsisë së vendit dhe përbën rreth tri të katërtat e furnizimit me peshk të vendit. Atje praktikohet gjithashtu edhe akuakultura, në një masë të vogël.

Sa i përket depozitave minerale të Malavit, ato nuk janë as mjaftueshëm të gjera për shfrytëzim komercial dhe as lehtësisht të arritshme. Në Livingstonia dhe Rumphu, në veri, ka disa miniera të

qymyrit që operojnë në shkallë të vogël; nxjerrja e gurit gëlqeror për prodhimin e çimentos është gjithashtu një aktivitet i rëndësishëm. Gurët e çmuar dhe gjysmë të çmuar nxirren në shkallë të vogël.

Burimet ujore të Malavit janë të bollshme, megjithëse disa zona rurale nuk furnizohen në mënyrë të mjaftueshme. Shumica e lumenjve janë sezonalë, por disa të mëdhenj, veçanërisht lumi Shire përgjatë rrjedhës së tij të mesme, kanë potencial të konsiderueshëm për ujitje dhe gjenerim të energjisë elektrike. Megjithatë, konsumatorët kryesorë të energjisë elektrike janë zonat industriale, dhe sa u përket banorëve të Malavit, vetëm një pjesë e tyre kanë akses në të; pothuajse të gjitha nevojat e brendshme për energji plotësohen nga drutë e zjarrit.

Zhvillimit të bazës industriale të vendit iu dha përparësi e lartë pas pavarësisë dhe Malavi tani plotëson pjesën më të madhe të nevojës së saj të brendshme për produkte të tilla si tekstile pambuku, ushqime të konservuara, vajra ushqimorë, sapun, sheqer, këpucë, etj. Megjithatë, kostoja e pjesëve të makinerive, pajisjeve dhe importeve të tjera të nevojshme për përdorim në industri, i ka bërë disa nga artikujt e prodhuar në vend shumë të shtrenjtë.

Importet kryesore të Malavit janë kimikatet dhe produkte kimike, produktet e naftës, mallrat e konsumit, makineritë, pajisjet e transportit, dhe ushqimi. Afrika e Jugut është partneri më i rëndësishëm tregtar i Malavit. Partnerë të tjerë tregtarë të tij janë Kina, Shtetet e Bashkuara, India dhe vendet fqinje afrikane.

GJUHA

Malavi modern përbëhet nga dhjetë grupe etnike kryesore, që janë: Çeva, Nianxha, Lomve, Jao, Tumbuka, Sena, Tonga, Ngoni, Ngonde dhe Lambja. Të gjitha gjuhët afrikane të folura në Malavi janë gjuhë Bantu.

Nga viti 1968 deri në vitin 1994, Çeva ishte gjuha e vetme kombëtare, e cila tani është një nga gjuhët e shumta të përdorura në median e shkruar dhe elektronike dhe flitet nga shumica e popullsisë. Në vitin 1996, politika qeveritare vendosi që arsimi në klasat 1-4 do të ofrohej në gjuhën amtare të nxënësve ose në gjuhën folëse. Nga klasa e 5-të, gjuha e mësimdhënies do të ishte anglishtja, e cila, megjithëse kuptohet nga më pak se një e pesta e popullsisë, vazhdon të përdoret gjerësisht (që



KRYEQYTETI, LILONGVE

nga koha kur vendi fitoi pavarësinë në vitin 1964) në çështjet e biznesit, në administratë, në gjyqësor, në arsimin e lartë, etj.

Gjuhë të tjera kryesore në vend janë: Lomve, Jao dhe Tumbuka.

FEJA

Muslimanët përbëjnë rreth 35-45% të popullsisë në Malavi. Feja tjetër më e madhe është ajo e krishtere, kurse besimet tradicionale ndiqen vetëm nga një pjesë e vogël e malavianëve.

HISTORI

Studimet antropologjike tregojnë se njerëzit kanë jetuar në Malavi që nga shekulli i 10-të para erës sonë. Në shekujt 1-4 para erës sonë, rajoni u pushtua nga populli Bantu, kurse historia e shkruar e njohur e vendit fillon në shekujt 13-14, kur muslimanët nga bregu i Afrikës lindore depërtuan në brendësi. Komuniteti suahili, i cili doli nga përzierja e muslimanëve arabë me vendasit afrikane me origjinë Bantu, dhe që jetonin në qytet-shtete përgjatë bregdetit nga Somalia deri në Afrikën e Jugut, u angazhua në tregti me brendësinë e kontinentit, që nga shekulli i 8-të e më vonë.

Sulltanati Kilva, në veçanti, vendosi marrëdhënie tregtare me fiset që jetonin përgjatë lumit Zambezi dhe rreth Liqenit Malavi, që nga shekulli i 14-të. Konfederata e Malavit, e formuar në vitin 1480, kontrollonte pjesën më të madhe të Malavit qendror dhe jugor deri në shekullin e 16-të. Pushtimi dhe shkatërrimi nga marina portugeze (në vitin 1505) i Kilvas dhe i qyteteve bregdetare pasuese që shtriheshin deri në Detin e Kuq, e dobësuan dominimin musliman në brigjet e Afrikës Lindore. Në vitet 1530, portugezët përparuan përgjatë lumit Zambezi dhe i skllavëruan muslimanët që kapën atje, të cilët i çuan në Brazil. Muslimanët që ikën nga

pushtimi mësynë kryesisht në brendësi të kontinentit.

Fisi Jao, që jetonte në brigjet e liqenit Malavi, u konvertua në Islam dhe u bë pjesë e Sulltanatit të Zanzibarit. Udhëheqësit e këtij fisi, të cilët arritën ta ruanin pozicionin e tyre të pavarur në marrëdhëniet me arabët dhe suahilianët, mbanin autoritetin e vetëm mbi transportin tregtar në rajon. Herë pas here, për shkak të urisë, fisi Jao bënin marrëveshje me tregtarët zanzibarë dhe migronin në brendësi të Malavit, në atdheun e fisit Çiçeva, ku arritën të konvertonin pjesërisht fiset Lomve, Nxhanxha dhe Manganxha.

Në shekullin e 19-të, Selim ibn Abdullahu, një figurë e shquar në Zanzibar, qëndroi për një kohë në qytetet tanzaniane Ujiji dhe Kilva, pastaj erdhi në Nkhotakota (Malavi qendror) me familjen dhe miqtë e tij. Ai bëri një marrëveshje me Marengën, kryetarin e fisit Çiçeva, dhe krijoi një pikë tregtare në brigjet perëndimore të liqenit Malavi. Në vitin 1840, Selim ibn Abdullahu e shpalli veten fillimisht si sulltan të Marimba-s, dhe më pas si “xhambe” (term i përdorur në gjuhën suahili për ‘sulltanin’), dhe sundimi që ai vendosi në Nkhotakota u quajt “periudha e xhambes”. Selim ibn Abdullahu, falë fisit Jao, transportoi lehtësisht mallra tregtare në ishujt bregdetarë të Kilva-s dhe Lindi-t. Pas vdekjes së tij (në vitin 1860), ai u pasua nga Mvingi-Mguzu dhe Mvingi Kisutu i Zanzibarit. Islami u përhap në Malavi në vitet 1860 përmes popullit Xhambe që fliste suahili. Krishterimi gjithashtu filloi të përhapet atje përmes misionarëve, në të njëjtën kohë.

Pas vdekjes së Mvingi-Kisutu (viti 1894), djali i tij, Mvingi Kheiri, e pasoi atë, duke mbështetur si luftën e tregtarëve arabë dhe suahili kundër tregtarëve britanikë, ashtu edhe rezistencën e fisit Jao - pothuajse tërësisht musliman - kundër kolonializmit. Në përgjigje,

britanikët, duke synuar të pushtonin rajonin, e rrëzuan nga fronti Mvingi Kheiri-n në vitin 1895, dhe e internuan në Zanzibar atë. Ata gjithashtu dëbuan tregtarët arabë dhe suahili, që kishin qenë aktivë në rajon për gati një shekull.

Makanxhila Banali i 3-të, një kryetar i fisit Jao që emigroi nga Rovuma (brenda kufijve të Tanzanisë së sotme, në lindje të liqenit Malavi) për në jug, u konvertua në Islam në vitin 1870. Krerë të tjerë, përfshirë Mataka, Xhalasi dhe Mponda, e ndoqën atë. Mlozi, një zanzibar, ishte figura e dytë më e rëndësishme në përhapjen e Islamit në Malavi; në vitin 1887, ai e shpalli veten Sulltan të Ngonde-s, dhe u vra në një luftë kundër sundimit kolonial britanik.

Britanikët, pasi e kolonizuan zyrtarisht Malavin nën emrin Niasaland, në vitin 1907 ia dhanë administrimin e tij një guvernatori kolonial, dhe në vitin 1953 e transformuan vendin në një federatë së bashku me Rodezinë. Populli malavian e kundërshtoi federatën sepse iu dhanë shumë pak të drejta, dhe malavianët luftuan deri në vitin 1963, kur rifituan 'status kolonial të pavarur'.

Në vitin 1830, misionarët në Afrikën lindore morën një qëndrim agresiv kundër muslimanëve, të cilët i shihnin si pengesën e tyre të vetme. Aktivitetet e tyre arsimore, duke filluar me Kishën e Skocisë në Mangoçi në vitin 1850, synonin të kristianizonin fiset Jao dhe Çiçeva. Nën udhëheqjen e David Livingstone, i cili mbërriti në Malavi në vitin 1859, shkollat misionare u hapën në të gjithë vendin dhe administrata koloniale ua la në dorë atyre të gjitha aktivitetet arsimore në vend. Fëmijët muslimanë nuk u regjistruan në këto shkolla, përveç atyre që pranuan emrat dhe pagëzimin e krishterë.

Nga ana tjetër, muslimanët refuzuan të lejonin hapjen e shkollave misionare dhe ndërtimin e kishave në rajonet e tyre. Britanikët, të cilët u përpoqën t'i japin fund arsimimit të muslimanëve, e konvertuan alfabetin që përdorej në shkrimin e gjuhës suahili, nga arab në atë latin. Pas dështimit të luftës së krerëve fisnorë Jao nën udhëheqjen e Mutaka Cisona i 5-të kundër gjermanëve, britanikëve dhe portugezëve, deri në vitin 1912 vendi u kolonizua plotësisht.

Nga viti 1928 e tutje, muslimanët nga India, të angazhuar kryesisht në tregti, filluan të mbërrinin në Malavi. Ata ndërtuan xhami dhe medrese, veçanërisht në qytetet Blantire dhe Zomba. Zomba, ish-kryeqyteti i vendit, konsiderohej qendra e muslimanëve malavianë. Në vitin 1940, në këtë qytet u themelua 'Shoqata e Arsimit Musliman', me ndihmën e muslimanëve

aziatikë. Mangoçi, Mulanxe, Blantire, Maçinga, Dedza, Çiradzulu, Lilongve, Selima dhe Nkhotakota, janë qytete të tjera me një popullsi të madhe muslimane. Në vitin 1946, muslimanëve iu lejua të hapnin shkolla të reja në Çiradzulu, Zomba dhe Mangoçi, dhe administrata e tyre iu dorëzua Organit Qendror Musliman të Arsimit. Ky institucion më vonë evoluoi në 'Shoqatën Muslimane të Malavit', e cila i bashkoi muslimanët e Malavit. Nga kjo datë deri në vitin 1962, numri i shkollave muslimane të hapura në të gjithë vendin arriti në njëzet e nëntë. Vetëm shtatë prej tyre morën mbështetje nga administrata koloniale, ndërsa të tjerat u mbyllën, ose e vazhduan punën e tyre në kushte të vështira.

Në vitet 1970, të rinjtë muslimanë filluan të ndiqnin shkollat fillore dhe të mesme, universitetet dhe shkollat teknike. Në vitin 1975, marrëdhëniet me muslimanët në Afrikën e Jugut u përmirësuan. Dy vjet më vonë, të rinjtë muslimanë të Malavit dërguan gjithashtu përfaqësues në konferencën e të rinjve muslimanë të mbajtur në Afrikën e Jugut. Konferenca e 3-të e të rinjve muslimanë të Afrikës së Jugut, e mbajtur në Blantire, në vitin 1981, i forcoi aktivitetet islame në vend. Komiteti Musliman i Malavit, i themeluar në Kuvajt, e ndryshoi emrin e tij në 'Agjencinë Muslimane të Afrikës', në vitin 1982. Nëpërmjet përpjekjeve të Shejh Sa'ad Et-Talib, i emëruar nga kjo organizatë, në Malavi brenda dhjetë viteve u hapën 300 xhami, njëzet qendra arsimore dhe dy klinika. Në vitin 1984, në të gjithë vendin kishte 6,000 xhami në të cilat falej namazi i xhumasë.

Pas pavarësisë së Malavi-t (viti 1964), Hastings Kamuzu Banda, një presbiterian që kishte studiuar mjekësi në Shtetet e Bashkuara dhe që ishte vënë në krye të vendit, vuri diktaturën atje dhe muslimanët u lanë në prapavijë.

Në vitin 1992, në Malavi filloi një periudhë ndryshimesh të shpejta politike. Bakili Muzuli, një udhëheqës musliman, formoi partinë politike 'Fronti Demokratik', një lëvizje të fortë opozitare kundër Hastings Kamuzu Banda. Në vitin 1994 në vend u prezantua politika shumëpartiake dhe Muzuli fitoi zgjedhjet. Lëvizja islamiste, e cila e kishte filluar veprimtarinë e saj në vitet 1980, ishte përhapur mjaft dhe disa nga figurat e saj kryesore, si Shuaibu Attimu, u bënë anëtarë të qeverisë së sapoformuar. Bakili Muzuli, i cili fitoi zgjedhjet presidenciale për herë të dytë në vitin 1999, vendosi bashkëpunim të ngushtë me vende si Kuvajti, Libia dhe Sudani, duke siguruar mbështetje

financiare për investime të shumta në vend.

Gjatë mandatit të Muzulit, Ministria e Arsimit Kombëtar e hoqi mësimin e Biblës në shkolla dhe e zëvendësoi atë me lëndën e mësimi mbi fetë botërore, ku mësoheshin Islami, Krishterimi dhe Judaizmi. Organizatat e themeluara nga muslimanët malavianë, të tilla si Xhemati Musliman i Limbe-s, Xhemati Musliman i Lilongve-s, Shoqata e Shkollave Muhamedane Kanienda dhe Shoqata Nuru Islam, u bashkuan nën ombrellën e 'Shoqatës Muslimane', dhe shkollat kuranore për fëmijët muslimanë u përhapën në të gjithë vendin.

Megjithatë, problemi i varfërisë që ekziston edhe sot në Malavi, rezulton në mungesë interesi për arsimim, veçanërisht për arsimin e lartë, ngaqë nxënësit nuk janë në gjendje të paguajnë tarifat e studimit. Studentët muslimanë në universitet në Malavi janë të pakët. Në Universitetin Malavi, në Zomba, ka vetëm 54 studentë muslimanë, dhe Universiteti Mzuzu ka afërsisht 40 studentë muslimanë, djem e vajza.

Këtu meriton të përmendet përpjekja e lavdërueshme e shoqatës muslimane 'Horizontet e së Ardhmes', e kryesuar nga Sheikh Wahid Bali, e cila mbështet dhe sponsorizon nxënësit e shkëlqyer dhe ua lehtëson atyre ndjekjen e arsimit të lartë, përfshirë edhe diplomat Master dhe Doktoraturë.

Në fillim të shekullit të 20-të, 70% e popullsisë së Malavit ishte muslimane. Por më pas kjo përqindje filloi të binte, për shkak të kolonializmit britanik dhe të aktiviteteve misionare të krishtera atje (madje, përpjekjet e kishave për të kristianizuar muslimanët vazhdojnë ende), derisa sot ajo ka arritur në afërsisht 35 - 40% të popullsisë. Disa muslimanë malavianë pretendojnë se përqindja nuk është më pak se 45%, por statistikën zyrtare qëllimisht e deklarojnë rreth 15% popullsinë muslimane, gjë që nuk është e saktë, siç e di kushdo që ka jetuar dhe udhëtuar në Malavi.

Muslimanët e Malavit janë ndjekës të shkollës Shafi'i, ndërsa muslimanët që kanë emigruar nga Azia përgjithësisht i përmbahen shkollës së mendimit Hanefi.

Studiues nga bregu i Afrikës lindore dhe anëtarë të xhematit Tablighi të Pakistanit kanë pasur ndikim të konsiderueshëm në ringjalljen e Islamit në Malavi.

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, teologe

<https://www.britannica.com>
<https://en.wikipedia.org>
<https://islamansiklopedisi.org.tr>
<https://al-forqan.net>

MYFTIU I SHKODRËS, TAKIM ME KRYETARIN E BASHKISË SHKODËR

Ditën e hënë, më 10 nëntor 2025, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari zhvilloi një takim pune në Bashkinë e Shkodrës, ku u prit nga Kryetari, z. Benet Beci.

Në takimin e përbashkët ku ishin të pranishëm edhe teologu Arben Halluni dhe deputeti i PS-së, z. Onid Bejleri, u diskutua rreth një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me bashkëpunimin dy palësh ndërmjet institucionit të Myftinisë Shkodër dhe Bashkisë së qytetit.

Gjatë këtij takimi, Myftiu shprehu shqetësimin e madh të Myftinisë Shkodër, të besimtarëve dhe qytetarëve shkodranë për aktin e paprecedent të ndërhyrjes, një natë më parë, të drejtorit të Policisë së Shkodrës në ambientet e xhamisë "Ebu Bekër" natën vonë për heqjen e një prej tabelave të Myftinisë Shkodër.

U vu theksi tek vlera e madhe e lirisë së besimit dhe domosdoshmëria e panegociushme për shkaputjen nga hijet e së kaluarës, respektimin e institucioneve fetare, shenjtërinë e



tyre dhe bashkëpunimin për të mirën e komunitetit, duke mos toleruar dhe lejuar në asnjë mënyrë që këto shenjtëri të shkelen nga askush dhe në asnjë moment.

Të dy bashkëbiseduesit ishin të mendimit se bashkëpunimet e frytshme të Myftinisë Shkodër dhe Bashkisë Shkodër nuk duhet të ngelen peng e incidenteve kalimtare dhe se interesi i përbashkët i komunitetit dhe i shoqërisë

qëndron më lart sesa krejt incidentet e padëshirueshme, që gjithsesi duhet të marrin dënimin e merituar në të gjitha format legjitime.

Myftinia Shkodër dhe Bashkia Shkodër do të vazhdojnë më tej bashkëpunimin dhe mirëkuptimin e tyre për një sërë projektesh të përbashkëta për të mirën e komunitetit dhe në shërbim të vlerave të patjetërsueshme të qytetarisë dhe paqes sociale.

DR. IBRAHIM MATAR, MIK I SHTRENJTË NË SHKODËR



që studiovan tek ne në Damask, në Fondacionin e Kryemyftiut të Sirisë, Shejkh Ahmed Keftaro!"

Më pas, bashkëbisedimi i ngrohtë vijoi me biseda me interes të përbashkët, me risjelljen në vëmendje të kujtimeve të shumta të periudhës, kur Myftiu i Shkodrës studiointe në Damask të Sirisë, dhe ku Dr. Ibrahim Matar ishte mësues dhe edukator i spikatur.

Vlen të theksohet, se Dr. Ibrahim Matar ka shërbyer për disa dekada si

mësues i gjuhës angleze, si hatib i disa xhamive, si ligjërues dhe pjesëmarrës në konferenca të ndryshme ndërkombëtare, sikurse njihet si përkthyes dhe shkrimtar, librat e të cilit janë botuar me mijëra kopje dhe janë shpërndarë në vende të ndryshme të botës arabe dhe islame.

Ai ka pasur nderin që në një periudhë të gjatë të jetës së tij të ishte një ndër përkthyesit e gjuhës angleze të Kryemyftiut të Sirisë, Shejkh Ahmed Keftaro.

MBRËMJE PËRKUJTIMORE PËR H. FEJZI ZAGANJORIN (1945 -2021)

Në kuadër të 35-vjetorit të rikthimit të lirisë së besimit në vendin tonë, më 11 nëntor 2025, në xhaminë e Rusit, pas namazit të akshamit, Myftinia Shkodër zhvilloi një mbrëmje përkujtimore kushtuar H. Fejzi Zaganjorit, imam me kontribute të mëdha fetare e kombëtare.

Programi u hap me lexim të Kuranit Famëllartë nga hafiz Gilman Molla, ndërsa me një fjalë hyrëse, Arben Halluni solli në vëmendje kontributin e çmuar të Haxhi Fejzi Zaganjorit në shërbim të fesë dhe atdheut.

Më pas, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, në fjalën e tij u ndal në disa momente domethënëse të jetës dhe veprës së Haxhi Fejzi Zaganjorit, i cili ka lënë gjurmë të pashlyeshme në edukimin shpirtëror të brezave për



dashurinë ndaj Zotit të Vetëm, ndjekjen e mësimave profetike, forcimin e familjes dhe kultivimin e paqes sociale.

Gjatë aktivitetit u shfaq edhe një pjesë nga ligjëratat e Haxhi Fejzi Zaganjorit, mbajtur pak muaj para se të ndërronte jetë, e cila përcolli emocione

të veçanta tek të pranishmit.

Mbrëmja u mbyll me vlerësime dhe mirënjohje për shpirtin e tij dhe për të gjithë ata që kanë shërbyer me përkushtim ndaj besimit dhe kombit shqiptar.



Ditën e martë, më 18 nëntor 2025, Myftinia Shkodër organizoi një seminar për imamët e qytetit dhe të fshatit, ku i ftuar ishte Dr. Ibrahim Matar, intelektual, përkthyes dhe shkrimtar nga Damasku i Sirisë.

Në krye të herës Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, pasi falënderoi mikun e shtrenjtë për përgjigjen e ftesës dhe praninë e tij në mesin e imamëve të Shkodrës, theksoi se takime të tilla janë një ushqim për zemrën, mendjen dhe shpirtin e gjithsecilit.

Myftiu theksoi se prania e një intelektual, shkrimtari dhe thirrësi islam që ka kaluar të 80-tat mbi supë, përveçse përgjegjësi është edhe një tërheqje vëmendjeje për gjithsecilin prej të pranishmëve, për respektimin e kohës, për vlerësimin e mikut dhe për ndarjen nga egoizmi dhe mendjemadhësia.

Në ligjëratën e mbajtur përpara imamëve të pranishëm, Dr. Ibrahim Matar, vuri theksin tek bazat e

KËSHILLA ZEMRE PËR IMAMËT E SHKODRËS



bashkëpunimit dhe komunikimit në mesin e thirrësve islamë dhe imamëve, si dhe rregullat e zhvillimit me sukses të thirrjes islame me këdo dhe në çdo kohë.

Profesor Ibrahim Matar dha disa këshilla me vlerë për imamët e pranishëm dhe nëpërmjet mesazheve të shumta gjatë ligjërimit të tij, vuri theksin tek sinqeriteti që duhet të ketë

imami dhe prijësi fetar në marrëdhënien e tij me Zotin e gjithësisë, në mënyrë që çdo hap i tij në këtë aktivitet të jetë i matur, i mirëpeshuar dhe në ekuilibër me kënaqësinë dhe pëlqimin e Zotit të gjithësisë.

Seminari vijoi me pyetje të ndryshme nga imamët e pranishëm, që u plotësuan me përgjigje të urta të pedagogut të nderuar damasken.

“DITA E RIHAPJES SË XHAMISË SË PLUMBIT – SIMBOL I LIRISË SË BESIMIT!”

Ditën e shtunë pas akshamit, më 15 nëntor 2025, në ambientet e Xhamisë së Plumbit, në kuadër aktiviteteve përkujtimore të 35 vjetorit të lirisë së besimit, u zhvillua një program i pasur fetar e kulturor, ku morën pjesë imamë, intelektualë, personalitete dhe besimtarë nga e gjithë zona.

Programi u hap me leximin e Kur'anit Famëllartë nga Hafizi Bajram Bilkimi.

Më pas, moderimin dhe prezantimin e aktivitetit e mbajti telogu Arben Halluni, i cili përshëndeti të pranishmit dhe prezantoi programin e këtij aktiviteti.

Në vijim, fjalën e mori Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili në mesazhin e tij theksoi rëndësinë e rikthimit të lirisë së besimit, rolin e Xhamisë së Plumbit në historinë e qytetit dhe vlerën e transmetimit të mesazheve të paqes, moralit dhe solidaritetit në komunitet.

Aktivitetin e përshëndeti edhe Dr. Ibrahim Matar, mysafiri nga Damasku, i cili vlerësoi nismën dhe rëndësinë e saj për edukimin dhe ndërgjegjësimin



e brezave të rinj.

Një moment i veçantë ishte fjala e njërit prej nismëtarëve të rihapjes së xhamisë së Plumbit, z. Mehdi Myftia, i cili solli kujtime dhe reflektime mbi përpjekjet e para dhe kontributet që e kanë bërë të mundur zhvillimin e sotëm të kësaj veprimtarie.

Programi vijoi me një recitim të bukur nga nxënësja e mejtepit të xhamisë Bardhaj, Erisa Fangaj.

Në kuadër të aktivitetit u shfaq edhe një pjesë filmike që dokumentonte ceremoninë madhështore të 16 nëntorit 1990, çast historik që shënon ringjalljen e besimit dhe hapjen e një kapitulli të ri për komunitetin musliman të Shkodrës dhe të mbarë Shqipërisë.

Në përmbyllje, të pranishmit morën pjesë në një koktej e shtruar me këtë rast, ndërsa programi u mbyll me faljen e namazit të jacisë.



35 VJETORI I LIRISË SË BESIMIT, MYFTIU VIZITOI KISHËN E RRMAJIT



Në kuadër të aktiviteteve përkujtimore të rikthimit 35 vitë më parë të lirisë së besimit në vendin tonë, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, zhvilloi ditën e martë, më 18 nëntor 2025 një vizitë miqësore në Kishën e Rrmajit, ku u prit ngrohtësisht nga Arqipeshkvi Shkodër-Pult, Mons. Giovanni Peragine dhe dom Mark Pashkja.

Vizita vjen gjithashtu si një kthim mirësie, pas takimit të pak ditëve më parë që Arqipeshkvi Peragine zhvilloi në Xhaminë e Plumbit, duke shënuar edhe një herë vlerat e bashkëjetesës dhe respektit të ndërsjellë që karakterizojnë qytetin e Shkodrës.



Gjatë takimit, të dy drejtuesit ndanë mesazhe të qarta për mediat, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes dhe kultivimit të frymës së harmonisë ndërfetare, trashëgimisë së etërve të besimit, që e kanë mbajtur Shkodrën shembull të bashkëjetesës, vëllazërisë, bashkëpunimit dhe respektit, si shtylla të pashkëputshme të paqes sociale, si dhe domosdoshmërinë e vijimit të traditës së dialogut dhe mirëkuptimit ndërmjet komuniteteve.

Mons. Peragine në prononcimin e tij mediatic përcolli mesazhin se liria e

besimit është një vlerë e çmuar, që duhet mbrojtur e forcuar për brezat që vijnë.

“...Sot në këtë vend jemi akoma duke përjetuar 35 vjetorin e lirisë në këtë vend që njerëzit e asaj kohe kanë pasur një guxim dhe kurajo të veçantë. Dhe pikërisht akoma sot ne kemi nevojë për njerëz guximtarë që luftojnë për lirinë, për dinjitetin e njeriut, sikurse kemi nevojë përmes guximit të tyre të sjellim më shumë paqe, harmoni sociale dhe dinjitet njerëzor...”

Ndërsa, Myftiu Sytari tha se Shkodra mbetet model i pjekurisë dhe harmonisë në gjithë trevat shqiptare dhe për këtë duhet të ecët në gjurmën e etërve që na kanë mëkuar më frymën e bashkëjetesës dhe mirëkuptimit ndërfetar.

“...Pa dyshim, se ky vend është për të menduar, për të reflektuar si dhe për të rikujtuar një nëntor të përbashkët të krishtenë dhe të myslimanëve që bashkërisht dhe me as një lloj dallimi, dorë për dorë dhe krah për krah shënuan ngjarjen më të rëndësishme të shekullit për ne. Besoj se ajo që ka ndodhur në atë nëntor të para 35 viteve është pa asnjë dyshim ngjarja më e rëndësishme e shekullit, ku njerëzit përgjodhën me u nda një herë e përgjithmonë nga dhuna, nga terrori komunist, nga dhunimi i lirive dhe të drejtave të njeriut...”

Më pas, Myftiu, i shoqëruar nga teologu Arben Halluni, vizituan mjediset e brendshme të kishës, duke parë nga afër vendin ku është mbajtur mesha e parë nga dom Simon Jubani pas rënies së diktaturës kriminale komuniste, një moment historik që shënoi ringjalljen e lirisë së besimit në Shqipëri. Po ashtu, ata vizituan edhe varrezat të Rrmajit, duke u ndalur në disa prej monumenteve të vjetra që dëshmojnë trashëgiminë shpirtërore dhe kulturore të zonës.



KREU I VATIKANIT, PAPA
LEONI I 14-TË:

“*Turkije është një shtet me shumicë myslimane, por ajo përfshin shumë komunitete të krishtera, ku pasuesit e feve të ndryshme jetojnë në paqe, edhe pse janë pakica të vogla!*”



Ditën e mërkurë, më 26 nëntor 2025, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një vizitë vëllazërore në Myftininë e Tetovës, ku u prit nga Myftiu i Tetovës, Dr. Selver Xhemaili.

Pas pritjes së ngrohtë në selinë e Myftinisë së Tetovës, dy myftilerët e nderuar, u shprehën përpara mediave me rastin e kësaj vizite duke vlerësuar frymën bashkëpunuese mes dy institucioneve dhe vullnetin për rritjen dhe forcimin e bashkëpunimeve në të ardhmen.

Myftiu Sytari u shpreh, duke thënë: “Është kënaqësi shumë e madhe takimi sot, në Myftininë e Tetovës me vëllain tim të shtrenjtë dhe mikun e vjetër, Myftiun e Tetovës, Dr. Selever Xhemaili.

Me ftesën e tij bujare, do të marrim pjesë bashkërisht në një aktivitet, i cili hedh dritë mbi rolin dhe kontributin e hoxhallarëve, por jo vetëm në çështjen kombëtare.

Si të thuash, sot jemi për çështjen tonë të përbashkët islame dhe kombëtare, si dhe për të përçarur disa mesazhe, që na interesojnë të gjithëve, drejt forcimit të harmonisë, vëllazërisë, bashkëpunimit dhe ruajtjes së ekuilibrave të kësaj vëllazërie që kemi me njëri-tjetrin.”

Ndërsa, Myftiu Xhemaili u shpreh: “Falënderoj Myftiun e Shkodrës, të

MYFTIU I SHKODRËS VIZITOI MYFTININË E TETOVËS



nderuarin Muhamed ef. Sytari, që gjeti kohë t'i përgjigjet ftesës tonë, që të jetë mysafiri ynë këtu në Tetovë, në Myftininë e Tetovës, me një nijet që të zhvillojmë një aktivitet të përbashkët që do të mbahet sonte, pas namazit të jacisë në xhaminë e Kallnikut.

Ky është një aktiviteti, siç e tha edhe Myftiu, i ndërlidhur me çështjen fetare dhe me atë kombëtare.

Por, sot unë kisha nderin ta mirëpres në zyrën e Myftinisë, Myftiun e nderuar, ku kaluam disa çaste të bukura, duke biseduar rreth aktiviteteve dhe bashkëpunimit të ndërsjellë dhe duke shpalosur edhe idetë e programeve

të përbashkëta, që do të realizojmë bashkërisht si Myftini e Tetovës dhe Myftini e Shkodrës.”

Më pas, takimi vëllazëror, vijoi me bashkëbisedimin e ngrohtë dhe të përzemërt, ku në fund u shkëmbyen edhe dhuratat simbolike.

Të dy myftilerët e nderuar, të shoqëruara me bashkëpunëtorët e tyre, falën namazin e akshamit në xhaminë e vjetër dhe me histori të madhe të Tetovës, në xhaminë e Larmë, nën drejtimin e Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili pas namazit përshëndeti xhematin e pranishëm me disa këshilla me vlerë dhe dobi.



FLAMURI, BESIMI DHE FËMIJËT – NJË DITË FESTIVE NË XHAMINË E OBLIKËS!

Myftinia Shkodër, përmes sektorit të arsimit, zhvilloi ditën e xhuma, më 28 nëntor 2025 një aktivitet festiv në xhaminë e Oblikës, me pjesëmarrjen e nxënësve të kurseve fetare, në kuadër të Festës së Pavarësisë dhe të Flamurit.

Në fjalën e tij të hapjes, drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni theksoi rëndësinë e ndërthurjes së vlerave fetare me ato atdhetare, duke i edukuar fëmijët dhe të rinjtë me dashurinë për Allahun (xh.sh), atdheun, historinë dhe trashëgiminë shpirtërore e kombëtare.

Fëmijët nën kujdesin e përgjegjës së përkushtuar të qendrës kulturore Oblikë, znj Kimete Elezi, sollën një program të larmishëm dhe mjaft të bukur, që përfshinte: recitime poezish patriotike, ilahi me përmbajtje shpirtërore, monologë dhe pjesë artistike, mesazhe për paqe, solidaritet dhe respekt ndaj flamurit tonë kombëtarë, etj.

Atmosfera festive, zëri i pastër i fëmijëve dhe emocionet e tyre e kthyen këtë aktivitet në një moment



domethënës për komunitetin e zonës Oblikë.

Në përfundim të programit, u hap gjithashtu një ekspozitë me materiale kombëtare, u shtrua një koktejl me ushqime tradicionale të zonës, ndërsa pjesa më interesante ishte dhurimi i flamujve kombëtarë nga nxënësit e qendrës për kalimtarët dhe automjetet e rastit, duke sjellë më shumë frymë festash, bashkimi dhe paqeje.



MEJTEPI IM... XHAMIA E PLUMBIT

PAK HISTORI:

- Xhamia e Plumbit ndodhet në lagjen Qafë, Bashkia Shkodër.

- Xhamia e Plumbit, një monument kulture i kategorisë së parë dhe një nga xhamitë më të vjetra e më të mëdha osmane në Shqipëri është ndërtuar nga Mehmet Pashë Plaku (Bushati), rreth viteve 1773-1774.

Ndërsa, restaurimi i thellë i xhamisë me vlera historike dhe arkitekturore si dhe rikualifikimit urban të territorit të saj u bë me financim nga qeveria turke, në maj të viteve 2024-2025.

- Lagja Qafë përbëhet prej rreth 90 familje myslimane.



Familjet më të njohura në lagjen Qafë janë: Myftia, Ishmi, Boshti (Molla), Nikshiqi, Mlika, Selhani, Alivoda, etj.

- Në këtë xhami nga viti 2002 deri më sot kanë shërbyer imam dhe mësues të mejtepeve; Besjana Dibra, Leartha Fejzaj, Mithat Myftia, Vesel Pisha, dhe imami dhe hafizi aktual, Hfz. Bajram Bilgin.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 12 kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami, në periudha të ndryshme nga viti 2002 -2025 është rreth 170 nxënës dhe nxënëse.

TAKIMI ME NXËNËSIT:

Në vijim të vizitave dhe takimeve të sektorit të arsimit, pranë Myftinisë Shkodër me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset-mejtepet e mësim-besimit, drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni, ditën e enjte, më 27 nëntor 2025 zhvilloi takimin e radhës me nxënësit e mejtepit të ri/kursit fetar të Kur'anit në xhaminë e Plumbit.

Fillimisht, teologu Halluni mbajti një bashkëbisedim, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin në përcimin te brezi i ri të mësimeve të vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit.

Më pas, drejtuesi i arsimit evidentoi ecurinë mësimore të nxënësve, zbatimin e programit mësimor të Myftinisë Shkodër, pjesëmarrjen e tyre dhe procesin mësimor nga Hfz. Bajram Bilgin.

Në fund të takimit u zhvilluan pyetje dhe përgjigje rreth mësimeve që marrin fëmijët gjatë këtij procesi mësimor në xhaminë e Plumbit.



16 NËNTOR 1990 - 2025



MYFTINIA SHKODËR URON
35 VJETORIN E LIRISË SË BESIMIT!

**"DUAN TA SHUAJNË DRITËN E ALLAHUT ME GOJËT E TYRE
DHE ALLAHU REFUZON, PËRVEÇSE TA PLOTËSOJË DRITËN E TIJ,
EDHE NËSE E URREJNË JOBESIMTARËT!"**

(KUR'ANI, ET-TEUBE: 32)



WWW.MYFTINIA-SHKODER.ORG

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org